

18.02.2022
Ora 12:48

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për caktimin e kohës së transmetimit falas në radiotelevizionin publik të fushatës zgjedhore të partive politike të regjistruara si subjekte zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Y. Merkaj, M. Koja**
- **Parti Politike:** **PD (M. Logu)**

Z. I. Celibashi: Përshëndetje, në seancën e sotme kemi në rendin e ditës katër çështje. Projektvendimin “Për caktimin e kohës së transmetimit falas në radiotelevizionin publik të fushatës zgjedhore të partive politike të regjistruara si subjekte zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022”. Kemi tre projektvendime të tjera të cilat lidhen me miratimin e vëzhguesve nga disa media, nga disa përfaqësi diplomatike të akredituara në Tiranë dhe nga një organizatë joqeveritare.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës që ka të bëjë me caktimin e kohës televizive në radiotelevizionin publik për subjektet zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhjet e 6 marsit. Po, sekretari për ta relatuar si projektakt.

Z. Y. Merkaj: Neni 90, pika 1 e Kodit Zgjedhor, ka parashikuar kompetencën e Komisionerit Shtetëror për monitorimin nëpërmjet administratës së Komisionit

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.02.2022*

Qendror të Zgjedhjeve apo subjekteve të kontraktuara, fushatën zgjedhore, të gjitha aspektet e financimit të fushatës zgjedhore, si dhe pasqyrimin e fushatës në media. Neni 80, pika 1 i Kodit Zgjedhor, përcakton se Radiotelevizioni Publik vë minutazh falas në dispozicion të partive politike të regjistruara në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve si subjekte zgjedhore për të bërë fushatë zgjedhore. Gjithashtu KQZ-ja cakton minutazhin për partitë parlamentare, sipas numrit të vendeve në Kuvend që ato kanë marrë në zgjedhjet e fundit, si dhe për partitë joparlamentare. Partive parlamentare të cilat në zgjedhjet e fundit për Kuvendin kanë marrë më shumë se 20 për qind të vendeve në Kuvend, KQZ-ja i cakton një minutazh të barabartë prej jo më pak se 30 minutash në Televizionin Publik dhe po aq në Radion Publike. Për partitë e tjera parlamentare që kanë marrë më pak se 20% të votave në parlament kjo kohë është jo më pak se 15 minuta në Televizionin Publik dhe jo më pak se 15 minuta në Radion Publike. Çdo parti joparlamentare që merr pjesë në zgjedhje, përfiton 10 minuta në Televizionin Publik dhe 10 minuta në Radion Publike. Me vendimin nr. 21, datë 13.07.2021, Komisioni Rregullator ka shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve të vitit 2021 për Kuvendin e Shqipërisë, duke përcaktuar numrin e mandateve të fituara nga secili subjekt zgjedhor, ku rezulton se:

Partitë parlamentare të cilat në zgjedhjet e fundit për Kuvendin kanë marrë më shumë se 20% të vendeve në Kuvend dhe janë regjistruar si subjekte zgjedhore për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore, të datës 6 Mars 2022, janë Partia Socialiste e Shqipërisë dhe Partia Demokratike. Parti tjetër parlamentare që në zgjedhjet e fundit për Kuvendin ka marrë më pak se 20% të vendeve në Kuvend dhe është regjistruar si subjekt zgjedhore për zgjedhjet e të datës 6 mars 2022, është Lëvizja Socialiste për Integrim. Duke analizuar nenin 80 pika 1, shkronja “b”, minutazhi falas ju vihet në dispozicion partive politike të regjistruara apo koalicionit bazuar në parimin e proporcionalitetit të numrit të konkurrentëve në garë. Sipas nenit 65 pika 3 të Kodit

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.02.2022*

Zgjedhor përcaktohet se të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për subjektet zgjedhore përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit. Koalicioni “Shtëpia e Lirisë”, ka deklaruar si parti udhëheqëse Partinë Lëvizja Socialiste për Integrim. Gjithashtu, si subjekt zgjedhore pjesëmarrës për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022 është regjistruar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve edhe partia politike joparlamentare, Lëvizja e Re që konkurren më vete. Ky subjekt duhet të përfitojë dhjetë minuta në Televizionin Publik dhe dhjetë minuta në Radion Publike. Në përfundim të analizës së mësipërme i propozohet Komisionerit, caktimin e një minutazhi kohor transmetimi të barabartë prej gjashtëdhjetë minutash, përkatësisht tridhjetë minuta në Televizionin Publik dhe tridhjetë minuta në Radion Publike, për pasqyrimin e fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore Partia Socialiste e Shqipërisë dhe Partia Demokratike. Caktimin e një minutazhi kohor transmetimi të barabartë prej tridhjetë minutash përkatësisht pesëmbëdhjetë minuta në Televizionin Publik dhe pesëmbëdhjetë minuta në Radion Publike, për pasqyrimin e fushatës zgjedhore të subjektit zgjedhor, Koalicioni “Shtëpia e Lirisë”. Caktimin e një minutazhi kohor transmetimi të barabartë prej njëzetë minuta përkatësisht dhjetë minuta në Televizionin Publik dhe dhjetë minuta në Radion Publike, për pasqyrimin e fushatës zgjedhore të subjektit zgjedhor, Lëvizja e Re. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësuesi i Partisë Demokratike!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Faleminderit zoti Celibashi! Jemi njohur me projektvendimin që u paraqit nga Sekretari i Përgjithshëm, jemi dakord me ndarjen e minutazhit që është bërë, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.02.2022*

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Atëherë, miratojmë projektaktin sipas draftit të propozuar. Pra, kemi tridhjetë minuta për Partinë Socialiste dhe Partinë Demokratike në Radiotelevizionin Publik falas, për të pasqyruar fushatën zgjedhore nga këto dy subjekte. Kemi pesëmbëdhjetë minuta për Koalicionin “Shtëpia e Lirisë” dhe dhjetë minuta për subjektin tjetër zgjedhor Lëvizja e Re. Respektivisht në radio dhe televizion, faleminderit!

Vendimi nr. 82

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



18.02.2022
Ora 12:54

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për miratimin e përfaqësuesve të medias TV “Fax News”, “Panorama Group”, “Media Motiv”, TV “A2 CNN”, “TV Kopliku”, për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
2.Stafi KQZ: **Y. Merkaj, M. Koja, E. Allushi**
- **Parti Politike:** **PD (M. Logu)**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me akreditimin e vëzhguesve. Nga disa media. Kemi “Fax News”, “Panorama Group”, “Media Motiv”, TV “A2 CNN”, “TV Kopliku”, këto janë. Janë në rregull me dokumentacionin?

Z. Y. Merkaj: Dokumentacioni është në rregull në përputhje me nenin 6, pika 5 të Kodi Zgjedhor.

Z. I. Celibashi: Përfaqësuesi i Partisë Demokratike, dakord?! Mirë, atëherë miratojmë akreditimin si vëzhgues për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022: të tridhjetë e pesë gazetarëve dhe operatorëve të TV “Fax News”, të pesëmbëdhjetë gazetarëve të “Panorama Group”, të

Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.02.2022*

njëmbëdhjetë gazetarëve të “Media Motiv”, të gjashtëdhjetë e tetë gazetarëve dhe operatorëve të TV “A2 CNN”, të pesë gazetarëve të TV “Kopliku”.

Vendimi nr. 83

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



18.02.2022
Ora 12:55

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për miratimin e vëzhguesve të Ambasadës së Republikës së Bullgarisë, për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Y. Merkaj, M. Koja, E. Allushi**
- **Parti Politike:** **PD (M. Logu)**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me kërkesën e Ambasadës së Republikës së Bullgarisë, për të akredituar disa vëzhgues. Janë në rregull?

Z. Y. Merkaj: Edhe kjo kërkesë është në rregull në përputhje me nenin 6, pika 5 të Kodi Zgjedhor.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësuesi i Partisë Demokratike, dakord?! Mirë, atëherë miratojmë edhe kërkesën e Ambasadës së Republikës së Bullgarisë për të pasur vëzhgues në zgjedhjet e Marsit. Janë gjashtë përfaqësues të kësaj ambasade të cilët marrin akreditimin për të qenë vëzhgues në këto zgjedhje.

Vendimi nr. 84

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



18.02.2022

Ora 12:56

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për miratimin e vëzhguesve të Qëndresa Qytetare, për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Y. Merkaj, M. Koja, E. Allushi**
- **Parti Politike:** **PD (M. Logu)**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën e fundit është Organizata jofitimprurëse Qëndresa Qytetare. Po!?

Z. Y. Merkaj: Kërkesa dhe dokumentacioni është në përputhje me nenin 6, pika 5 të Kodi Zgjedhor dhe nenin 6, pika 2 të Kodit Zgjedhor, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësuesit e partive janë dakord besoj?! Atëherë miratohet dhe kërkesa e Organizatës jofitimprurëse Qëndresa Qytetare për të akredituar gjashtëmbëdhjetë përfaqësues të kësaj organizate si vëzhgues në zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022. Pikë tjetër të rendit të ditës nuk kemi, faleminderit!

Vendimi nr. 85

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



18.02.2022
Ora 12:58

JASHTË RENDIT TË DITËS

PJESËMARRJA :


- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Y. Merkaj, M. Koja, E. Allushi**
- **Parti Politike:** **PD (M. Logu)**

Z. I. Celibashi: I japim fjalën përfaqësuesit të Partisë Demokratike për çështje të cilat janë jashtë rendit të ditës.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Faleminderit, zoti Celibashi! Në fakt do të doja një informacion lidhur, tashmë është bërë dhe publike që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka filluar hetimin administrativ për dy rastet e denoncuara nga Partia Demokratike, përkatësisht në Bashkinë Durrës dhe Bashkinë Rrogozhinë. Në datën 14 shkurt janë dërguar të dy kërkesat për informacion, do të donim të dinim, meqenëse dhe afati në ato dy shkresa ishte 24-orë nga momenti i marrjes së kësaj kërkesë. Tashmë kanë kaluar tre ditë, në qoftë se ka pasur ndonjë përgjigje nga Bashkia Durrës, apo Rrogozhinë?

Z. Y. Merkaj: Kemi dërguar kërkesën Bashkisë Durrës dhe Bashkisë Rrogozhinë për informacion, duke u bazuar në denoncimet që ka bërë përfaqësuesi i Partisë Demokratike. Ende nuk kemi përgjigje nga të dy bashkitë.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.02.2022*

Z. I. Celibashi: Ua kemi nisur menjëherë, por problemi është, kanë kthyer ata përgjigje apo jo? Kjo është pyetja apo jo?

Z. Y. Merkaj: Ende nuk kanë kthyer përgjigje.

Z. I. Celibashi: Mirë, atëherë duhet të marrim kontakt edhe në mënyrë tjetër, telefonike për të parë se ku janë me përgjigjen. Në fakt kemi caktuar një afat 24-orë për të kthyer përgjigje. Ata mund ta sjellin edhe me e-mail, nuk ka nevojë ta sjellin me postë. Ata kontaktin e kanë të KQZ-së. Pas përfundimit të kësaj seance duhet të komunikojmë menjëherë për të marrë informacionin e kërkuar. Po, çështje tjetër?

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Një çështje tjetër zoti Komisioner! A ka pasur raste kur bashkitë apo institucionet e tjera vendore, qendrore kanë raportuar veprimtari publike, e para kjo! A ka pasur raste kur këto veprimtari janë ndaluar nga KQZ-ja pasi janë gjetur në kundërshtim me Kodin Zgjedhor dhe aktet nënligjore?

Z. Y. Merkaj: Te portali “Denoncime” kemi pasur thjesht vetëm raportimet e aktiviteteve, por nuk kemi pasur denoncime.

Z. I. Celibashi: Nga aktivitetet që janë raportuar, të paktën ato çfarë janë raportuar në portalin përkatës në KQZ, nuk rezulton që aktivitetet të jenë të tilla që do të duhet të ndalohen nga KQZ-ja deri tani. Në se keni ndonjë rast specifik, jeni të lutur ta bëni me dije dhe ta verifikojmë, investigojmë.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Kemi dy raste të konstatuara nga ana jonë, por do t'i sjellim me shkrim, në formën e një ankimi.

Z. I. Celibashi: Dakord! Mirë faleminderit, seanca mbyllet, ditë të mbarë!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

